

**KUR PËRFUNDON TRANZICIONI?
TEORIA KUNDREJT REALITETIT NË RASTIN E
SHQIPËRISË**

Komente nga Prof. Dr. Genc RULI

- Që tranzicioni post-komunist është përgjithësisht drejt fundit të tij, kjo vërehet nga fakti se debati i madh mbi interpretimin historik të tij, tashmë ka filluar.

Megjithatë ky është një konstatim i përgjithshëm, pasi vendet e veçanta të tranzicionit, sot pas 12 vitesh të fillimit të tij, ndodhen në largësi të ndryshme nga pika e mbërritjes, pra përfundimi i tij.

Për Poloninë, Republikën Çeke, Hungarinë apo Slloveninë sot nuk po përdoret më denominativi “vende në tranzicion”, por në vend të tij përdoret “vende në post-tranzicion”. Disa vende të tjera si për Shqipëri, Shtetet Baltike cilësohen si vende “të tranzicionit të suksesshëm”, të tjera si Rusia e mjaft ish-republika të Bashkimit Sovjetik cilësohen “vende të tranzicionit të dështuar”, ndërsa vendet e Ballkanit si vende “të tranzicionit të vështirë”, “të vonuar” apo “të ndërprerë”.

- Nga ana tjetër, duke filluar nga mesi i dekadës së kaluar, para shumicës së vendeve të tranzicionit (kryesisht atyre të Evropës Qendrore e Juglindore) u paraqit një perspektivë e re historike, mundësia për t’u integruar në Bashkimin Evropian. Me avancimin gjatë viteve pasuese, të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian drejt ish-botës komuniste, axhenda e tranzicionit u mpleks me axhendën e integritit, madje shpesh kjo e fundit po bëhej më prioritare e lakmuese për vendet mëtonjëse. Vende të ndryshme tashmë më shpesh kategorizohen sipas afërsisë që kanë arritur në raport me Bashkimin Evropian se sa sipas stadit të avancimit në tranzicion. Vendeve në tranzicion, të cilat priten të pranohen në vitin 2004, iu akordua statusi i “ekonomisë së tregut funksionale”, pak kohë më parë. Pra, praktikisht pranohet se këto vende e kanë përfunduar, përgjithësisht me sukses korpusin e reformave transformuese të tranzicionit post-komunist.

A mos duhet të mendojmë, në këto rrethana të reja, se si moment i përfundimit të tranzicionit do të pranohet momenti në të cilin vendi arrin të bëhet kandidat apo anëtar i Bashkimit Evropian. Në fakt, këto dy realitete, ndonëse koincidojnë në kohë, nuk janë reciprokisht të lidhura e të kushtëzuara veçse në një drejtim: statusi i anëtarit të Bashkimit Evropian, nuk mund të fitohet nga një vend që ende nuk ka përfunduar tranzicionin post-komunist. Strategjitë e afrimit dhe të pranimit në Bashkimin Evropian nuk përputhen tërësisht me strategjitë e tranzicionit dhe të zhvillimit, në disa aspekte ato dhe nuk janë komplementare e madje dhe kundërshtohen mes tyre.

- Tranzicioni, teorikisht është quajtur procesi historik gjatë të cilit shoqëritë ish-komuniste kryejnë transformimet radikale të regjimit politik e ekonomik socialist në atë të demokracisë pluraliste e të ekonomisë së tregut. Pra, në aspektin ekonomik, përgjatë periudhës së tranzicionit sistemi ekonomik s’është më socialist por ende nuk është as tërësisht kapitalist. Integrimi në Bashkimin Evropian, përbën një anëtarësim politik dhe ekonomik në grupimin e vendeve më të zhvilluara të botës, atyre të Evropës Perëndimore, që dallohen si për nivelin e konsoliduar të demokracisë liberale, ashtu dhe për shkallën e funksionalitetit të tregut të tyre e të konkurrueshmërisë së ekonomive të tyre.

Përfundimi i tranzicionit, teorikisht dhe praktikisht, është momenti në të cilin sistemi ekonomik pushon së transformuari (nga një tip sistemi në tjetrin) dhe ai “ngrin” përfundimisht në formën e modelit të synuar. Pas këtij momenti, sistemi ekonomik i vendit nuk është më një sistem “në tranzicion”, por një sistem “normal” i tregut të lirë. Politikat ekonomike që ndiqen më pas pushojnë së qenuri politika tranzicioni, duke qenë politika zhvillimi e modernizimi.

- Në fillim të viteve 1990, mjaft studjues e analistë të tranzicionit post-komunist, parashikonin një afat optimal prej 10 vjetësh për kryerjen e transformimeve të sistemit ekonomik dhe afërsisht 4-5 vjet për transformimin e sistemit politik

Por në realizimin praktik, tranzicioni rezultoi një proces tej mase kompleks dhe me një variacion të madh në performancat e vendeve të ndryshme. Rezultatet dhe ecuria e tij u ndikuan ndjeshëm si nga kushtet specifike të nisjes të çdo vendi, ashtu dhe nga modeli i transformimeve që u ndoq dhe konsistenca në kryerjen e reformave.

- Në mjaft vende procesi i tranzicionit u mpleks dhe me fenomene të tjera të natyrës jotranzicionale si: lufrat civile, konfliktet etnike apo formimi i shteteve kombëtare.
- Ndërsa vendet e tranzicionit nuk mund të cilësohen si të varfëra në shumë aspekte të tyre, mjaft prej tyre (përfshirë vendet e Ballkanit, pra dhe Shqipërinë), u përballën dhe me një sërë problemesh që janë karakteristike për vendet e varfëra si: institucione të dobta, pabarazi në rritje, paaftësi e elitës politike.

Pra, simptoma të nënzhvillimit (underdevelopment) të shfaqura më dukshëm gjatë viteve të tranzicionit, kanë sjellë një “demodernizim” të shoqërive tona, që shfaqet në këto drejtime:

- Deindustrializim (riagrarizim) i ekonomive kombëtare.
- Prani e ndjeshme e veprimit të institucioneve joformale (paramoderne).
- Dobësim i kapitalit social (polarizim i thelluar i pasurive, urbanizim i egër, korrupsion i lartë, marzhinalizim i grupeve sociale, rritje e kriminalitetit).
- Varfërimi i kapitalit human (rrënim i ndjeshëm i sistemit arsimor, përkeqësim i shërbimeve shëndetësore, dobësi e sistemit të mbrojtjes sociale, “brain-drain” etj.).

Politikat që duhet të ndërmerren për përballimin e këtyre problemeve, nuk janë të natyrës tranzicionale, por përbëjnë politika të mirëfillta zhvillimi (development). Pra, vendeve si ne u duhet të përballojnë një proces shumë më kompleks sesa thjesht tranzicioni post-komunist.

Në cilin moment të tranzicionit ndodhet sot Shqipëria?

- Gjykuar nga tërësia e indikatorëve të progresit në reformat e tranzicionit, mund të thuhet se Shqipëria ka arritur deri më sot një përparim të nivelit mesatar (krahasuar me tërë grupin e vendeve në tranzicion). Stabiliteti makroekonomik ka rezultuar i qëndrueshëm për periudha të gjata kohe; shkalla e privatizimit të ekonomive është e lartë, mbi 75 për qind; liberalizimi i tregut pothuajse i plotë; ritmet e rritjes gjatë 10 vjetëve përgjithësisht të larta; shkalla e hapjes së ekonomisë ka një trend rritës; ndërtimi i institucioneve të tregut pjesërisht i kryer.
- Është pranuar se tranzicioni zhvillohet në tre stade reformash:

Stadi I, përbëhet kryesisht nga politikat e stabilizimit makroekonomik, por dhe nga mjaft reforma strukturore që shënojnë fillimin e kalimit në ekonominë e tregut.

Stadi II, cilësohet si periudha e konsolidimit dhe e administrimit të tranzicionit, me një përqendrim në reformat institucionale e ligjore që konsolidojnë themelet e ekonomisë së tregut. (Ky stad kërkon domosdoshmërisht një administratë kompetente e një qeveri të fortë.)

Stadi III, do të jetë procesi i rritjes dhe i konvergjencës (“catching-up”).

Në raport me këtë fazim historik, Shqipëria ndodhet sot diku në mes të proceseve të stadi të dytë. Duke e konsideruar si moment të kalimit në këtë stad, vitin 1995, konstatojmë një qëndrim të tejzgjatur në këtë stad dhe një përparim të ngadaltë dhe spazmatik në reformat e tij.

Pra, nëse pranojmë që Shqipëria ka sot një ekonomi të tregut, nuk do të kishim argumente të mjaftueshme për të pohuar se ekonomia jonë e tregut është “funktionale”. Dobësi të ndjeshme të vetë karakterit të sistemit, imponojnë këtë vlerësim, sikundër janë: mungesa e disiplinës financiare, transparencë e stabilitet i pakët i kuadrit rregullues; zbatim i pamjaftueshëm apo i deformuar i rregullave të tregut; administratë publike inefficente; një gjyqësor i papranueshëm.

Ndërsa ekonomia shqiptare është ende sot mjaft vulnerabël dhe jo e vetmbajtëshme, duke u karakterizuar nga:

- Deficit i jashtëm i paqëndrueshëm.
- Deficit fiskal i lartë e ndoshta shpejt i papërballueshëm.
- Sektor bujqësor problematik.
- Nivele të larta e rrezikuese të papunësisë e treg pune jofleksibël.
- Kredibilitet i pamjaftueshëm i sektorit bankar e përgjithësisht një treg financiar i zhvilluar dobët.
- Privatizim i ngadaltë e inefficient.
- Sistem i dobët i mbrojtjes sociale.

Kostoja marzhinale e vonësive në kryerjen e reformave strukturore e institucionale, rritet me kohën. Pra, sfida e përshpejtimit të kryerjes së tyre sot, është disa herë më e madhe sot se disa vite më parë.

- Një çështje e rëndësishme që do të doja të prekja në funksion të këtij debati mbi tranzicionin shqiptar, është problemi i rritjes ekonomike dhe i trendeve të pritshme të saj.

Rritja e lartë ekonomike përbën një faktor tepër të rëndësishëm si për të mbështetur e për të lehtësuar reformat e tranzicionit, por sidomos përgjatë stadiut të tretë të tij, për të siguruar modernizimin e konvergjencën e ekonomisë së vendit.

Si e tillë rritja ekonomike duhet të jetë e gjeneruar nga vetë reformat, e qëndrueshme dhe afatgjatë.

- Por, cila ka qenë tipologjia e rritjes ekonomike të deritanishme në Shqipëri.
 - Ritmet e rritjes të ekonomisë sonë kanë qenë veçanërisht të larta (mbi 8 për qind gjatë periudhave 1993-1996 dhe 1999-2000).
 - Por në një pjesë të saj, kjo rritje nuk është efekt i drejtpërdrejtë i reformave, por i kontrastit të krijuar nga rëniet drastike të prodhimit në periudhën 1988-1992 e sërisht në 1997-1998.
 - Pjesërisht kjo rritje përmban dhe ndikimin e flukseve të jashtme financiare (të cilat në PBB-në e vendit mund të kenë ndikuar në masën deri në 20 për qind).
 - Të paktën deri para dy vjetësh dinamika e lartë e rritjes ekonomike erdhi kryesisht nga një avantazh specifik për Shqipërinë: të qenurit një vend kryesisht agrar (në teorinë ekonomike të zhvillimit ky quhet “avantazhi i prapambetjes”). Sektori bujqësor u zhvillua shpejt në dekadën e kaluar, nxitur vetëm nga liberalizmi e privatizimi i tij. Efektet e këtij avantazhi sot mund të quhen të ezauruara, madje sektori i madh bujqësor mund të kthehet në një frenues të rritjes në vitet e ardhshme në qoftë se ai nuk i nënshtrohet një ristrukturimi të thellë e nuk preket nga investime të ndjeshme në teknologji.
 - Rritja ekonomike përgjatë tranzicionit u gjenerua kryesisht nga sektori i ri privat, se sa nga sektori i trashëguar shtetëror (sektori privat realizon rreth 70 për qind të PBB-së). Por, duhet pranuar se sektori i ri privat, ndonëse dinamik, po zhvillohet ende me një strukturë të atomizuar (biznese të vogla e tepër të vogla) e me një komponent të ndjeshëm informal, gjë që vështirëson si akumulimin e kapitalit ashtu dhe institucionalizimin e tregut.
 - Normat e kursimeve e të investimeve në vend, janë ende të ulëta shoqëruar kjo dhe me alokime joeficiente e joproduktive të kapitalit. Ende jemi larg normave optimale të akumulimit të kapitalit e sidomos të produktivitetit të kapitalit e të punës

Pra, nuk është e vështirë të kuptohet se rritja ekonomike e siguruar gjatë këtyre viteve të tranzicionit, pavarësisht ritmeve të larta të saj, është larg së qenuri një rritje e qëndrueshme e afatgjatë. Kjo e fundit do të kërkonte domosdoshmërisht rritje të ndjeshme në asetet kapitale, futjen e teknologjive të reja, riindustrializimin e ekonomisë kombëtare dhe investime sistematike në kapitalin human.

Në qoftë se vendi ynë nuk do të arrijë të krijojë një rritje të qëndrueshme në një periudhë afatmesme (5-7 vjet), ai rrezikon të mbetet i kllaposur në orbitën e prirjeve negative dhe të jetë pre e krizave kronike të nënzhvillimit.

- Por, duhet pranuar se në këtë moment në ekonominë shqiptare (si dhe në gjithë ekonominë e rajonit tonë) potencialet e nevojshme për të siguruar një rritje të shpejtë dhe për të realizuar “catching- up” me Evropën Perëndimore, janë të pamjaftueshme.

Politikat e mira ekonomike (shpesh të munguara) janë një parakusht thelbësor i progresit të ardhshëm, por jo një faktor i mjaftueshëm. Një perspektivë konkrete për integrimin në Bashkimin Evropian dhe një ndihmë e ndjeshme financiare do të jenë përcaktuese. Objektivi i integritit në Bashkimin Evropian është më i rëndësishëm sesa vetë anëtarësimi në të.